

KËRKESË
Nr. 639/1, datë 9.3.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË FTESËN PËR OFERTË PËR PROCESIN
KONKURRUES, “PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTIT QË DO TË PËRFITOJË
MASAT MBËSHTETËSE PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË
ZONËN E KARAVASTASË”**

Bazuar në vendimin nr. 349, datë 12.6.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre”, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka shpallur ftesën për ofertë për procesin konkurrues për përzgjedhjen e ofertuesit për zhvillimin e “Projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik, në zonën e Karavastasë”.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
“PËR NJË NDRYSHIM NË FTESËN PËR OFERTË”

Në ftesën për ofertë për Procesin Konkurrues, “Për përzgjedhjen e projektit që do të përfitojë masat mbështetëse për ndërtimin e impiantit fotovoltaik në zonën e Karavastasë”, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, të datës 20.1.2020 dhe 27.2.2020, bëhet ndryshimi i afatit për dorëzimin e ofertave dhe hapjes së ofertave, si më poshtë:

Afati për dorëzimin e ofertave: 30 mars 2020, ora 12:00 (ora e Evropës Qendrore).

Hapja e ofertave: 30 mars 2020, ora 12:00 (ora e Evropës Qendrore).

Informacion shtesë mbi dokumentet e procesit konkurrues mund të gjeni në *Website*-in e Autoritetit Kontraktues: <http://infrastruktura.gov.al>.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Viola Haxhiademi